



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/785/110-478
27.02.2018

PËR / ZA / TO	Ministrin e Tregtis dhe Industrisë, z. Bajram Hasani	DATE DATUM DATE	27/02/2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Mimoza Kusari – Lila, Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Gjatë raportimit tuaj pranë Komisionit për Zhvillim Ekonomik, tregti, industri, energji dhe infrastrukturë, me datë 7 Shkurt, në pyetjen e deputetëve për procesin e përzgjedhjes jashtë standardit të Sekretarit të MTI - së, ju Ministër keni deklaruar: "Përzgjedhja ka qenë në rregull, por ndoshta përzgjedhja e personit të përfolur do t'ia prishë çerdhen dikujt dhe tani po kemi reagime të pabaza". Në vazhdimin e pyetjes time për "çerdhen" e kujt po flisni, Ju ministër u përgjigjet "çerdhen tuaj".

Pyetje : 1.Ministër, kush janë personat në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të cilët i identifikoni të "çerdhes" time nga koha sa isha Ministre e Tregtisë dhe Industrisë?
2. A i keni verifikuar përgatitjet profesionale të këtyre personave dhe procesin e përzgjedhjes së tyre?
3.Çfarë masash keni ndërmarrë për "prishjen" e kësaj "çerdheje"?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIK OF KOSOVO KUVENDI I REPUBLIKES SË KOSOVES SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA АСМБЛЕЈА РЕПУБЛИКЕ ОФ КОСОВО	
Kuvendi i Propozimit dhe Propozicionit, Propozime dhe Propozicione Предлог и Предлог, Предлог и Предлог	
No. E Prop. No. Prop. Prop. No.	06/1187/0656
Data Datum Date:	27.04.2018
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

PËR/ZA/TO	<i>Ministren e Mjesdisit dhe Planifikimi Hapësinor zgj. Albena Reshitaj</i>	DATE DATUM DATE	27.04.2018
NGA/OD/FROM	<i>Deputetja Ganimete Musllu</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	<i>Pyetje për përgjigje me gojë</i>		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

E nderuara Ministre:

Të gjithë jemi të njoftuar se gjatë sezonës së kaluar dimërore të gjithë vizitorët që kanë vizituar Brezovicën kanë paguar taksë hyrëse për persona dhe automjete, dhe kjo nuk ka qenë ndonjë shumë e pavërejtur.

PYETJE :

E nderuara Ministre:

Ku janë shpenzuar të hyrat nga taksim i qytetarëve pasi që, gjendja momentale e rrugës që të shpie në Parkun Nacional të Brezovicës është e shkatërruar dhe gati e pakalueshme për automjetet, si dhe ambienti është i kontaminuar nga mbeturinat e mbetura nga sezoni dimëror?

Thjesht ai vend ka mbetur nën mëshirën e fatit dhe sikur është barktisur nga kujdesi institucional?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

658/193/110658
30.04.2018

PËR / ZA / TO	Z. Uran Ismaili Ministër i Shëndetësisë	DATE DATUM DATE	30.04.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Besa Baftiu Deputete e Grupit të Deputetëve të Pavarur		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Ndërtimi i Spitalit Pediatrik në hapësirën e QKUK-së

Pyetja Parlamentare:

Ndërtimi i Spitalit Pediatrik në hapësirën e QKUK-së që do të integrojë shërbimet shëndetësore që kanë të bëjnë me fëmijët sipas planit do të duhej të përfundonte në fund të këtij viti. Ky projekt ka vlerë prej 22 milion euro dhe është donacion nga Emiratet e Bashkuara Arabe.

Z. ministër pse ende nuk ka filluar së ndërtuari ky spital, ku qëndron problemi kur dihet se Minsitria e Shëndetësisë është deklaruar se do të jap mbështetjen në të gjitha fazat me qëllim që projekti të përfundojë me kohë.